

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI ARSIMOR PËR CIKLIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: EDUKATË SHOQËRORE

(klasa e nëntë)

Viti shkollor 2008-2009

TË PËRGJITHSHME

Edukimi qytetar demokratik përmbledh në vetvete një tërësi konceptesh ose vlerash themelore që janë të përbashkëta për të gjithë demokracitë moderne. Të kuptuarit ashtu siç duhet i këtyre koncepteve dhe vlerave dhe i marrëdhënieve të tyre në kushtet e ndryshimeve të shpejta, si dhe i rreziqeve që bartin, është kushti paraprak për një pjesëmarrje të efektshme dhe të përgjegjshme të qytetarëve në procesin e rindërtimit demokratik. Ja disa nga këto koncepte:

- *të drejtat e njeriut dhe liritë themelore* (universaliteti, karakteri i pandashëm dhe i patjetërsueshëm i të drejtave dhe lirive, i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; legjislatiioni ndërkombëtar i të drejtave të njeriut; të drejtat e trashëguara; institucionet dhe procedurat për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut);
- *demokracia* (institucionet dhe procedurat; përfaqësimi dhe demokracia pjesëmarrëse; liritë demokratike) dhe *parimet demokratike* (përparësia e ligjit dhe e së drejtës, drejtësia shoqërore; barazia, pluralizmi; kohezioni shoqëror; përfshirja; mbrojtja e minoriteteve, solidariteti; paqja, stabiliteti dhe siguria);
- *qytetari* (fuqizimi dhe përgjegjësia; pjesëmarrje aktive);
- *shoqëria civile* (parimet, institucionet dhe procedurat e një shoqërie civile; fuqizimi i shoqërisë civile; marrëdhëniet me shtetin);
- *zhvillimi* (ndryshime të qëndrueshme).

Aftësitë

Përdorimi si duhet i koncepteve dhe i vlerave demokratike varet shumë nga zhvillimi i aftësive të tilla si:

1. Aftësitë themelore

- aftësitë e të menduarit kritik
- aftësitë e të qenit krijues dhe i efektshëm
- aftësitë për të zgjidhur problemet
- aftësitë për të vlerësuar
- aftësitë për të zbatuar njohuritë, edhe ato procedurale
- aftësitë për arsyetime dhe reflektime morale.

2. Aftësitë e veçanta që lidhen me sjelljen shoqërore

- aftësitë pjesëmarrëse
- aftësitë e shumëfishta komunikuese
- aftësitë për të bashkëpunuar dhe punuar në grupe
- aftësitë për të debatuar, negociuar dhe bërë kompromise
- aftësitë ndërkulturore
- aftësitë për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet
- aftësitë për të ndërmjetësuar
- aftësitë për të shpallur të drejtat vetjake pa shkelur të drejtat e të tjerëve
- aftësitë për të marrë përsipër përgjegjësi demokratike.

3. Qëndrimet

Përveç të kuptuarit të koncepteve dhe të vlerave themelore dhe fitimit të aftësive themelore për një pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme, për qytetarin janë të nevojshme edhe një tërësi qëndrimesh aktive shoqërore, të përcaktuara përgjithësisht në kuadrin e pjesëmarrjes dhe përkushtimit ndaj vlerave të njohura e të pranuara si universale në shoqëri, si:

- përkushtimi ndaj parimit të universalitetit, të ndërvlerësish dhe të pandashmërisë së të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;
- bindja për vlerën, dinjitetin dhe lirinë e individit;
- përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë;
- përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore;
- bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar;
- respektimi i kulturave të tjera dhe i ndihmesës së tyre për njerëzimin; pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjyqimeve dhe çdo forme të diskriminimit;
- bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë personale;
- përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysh ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.

Cilat janë disa nga kompetencat e aktorëve kryesorë në procesin e edukimit qytetar demokratik, të nxënësit dhe të mësuesit?

Edukimi qytetar demokratik synon të zëvendësojë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënësit, në të cilat roli i mësuesit reduktohet në transmetimin e dijeve dhe të aftësive dhe ai i nxënësit në të dëgjuarit pasiv dhe, në rastin më të mirë, në përvetësimin e përmbajtjes së transmetuar. Edukimi për qytetarinë demokratike nënkupton mundësitë e shumta të të mësuarit që ofron “shoqëria e të nxënësit”. Ai del përtej kufijve të shkollës dhe të komunitetit dhe sfidon ndarjen që ekziston ndërmjet edukimit formal dhe atij joformal, ndërmjet veprimtarive kurrikulare dhe atyre jashtëshkollore, si dhe ndërmjet shkollimit dhe shoqërizimit. Si i tillë, ai zhvillon karakterin e ndërsjellë të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësit dhe nxit këmbimin e vazhdueshëm të rolit të mësuesve dhe të nxënësve. Në të njëjtën kohë, duke u përqendruar në fitimin e aftësive dhe të kompetencave të nevojshme për veprimin dhe ndryshimin shoqëror, edukimi për qytetarinë demokratike ruan të gjitha karakteristikat e një përpyekjeje të paramenduar njerëzore që harmonizon teorizimet dhe diskutimin publik.

Në këtë kuadër, mësuesit shfaqen më tepër si organizatorë të mundësive të shumëfishta të të mësuarit dhe si ura që lidhin burimet shoqërore me përdoruesit e tyre. Ata ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë mundësinë e marrjes së informacionit dhe ndjekin në vazhdimësi sfidat e reja shoqërore, politike dhe teknologjike, si dhe nevojat gjithnjë në rritje të nxënësve të tyre. Nxënësit, gjithashtu, marrin pjesë aktivisht në vendimet lidhur me procesin edukativ, veçanërisht në ato që lidhen me përmbajtjen, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies/të nxënësit për qytetarinë demokratike. Mësimdhënia bëhet kështu një proces ndërveprues, në të cilin jo vetëm

diskutohen qëllimet edukative, por edhe njihen e shkëmbehen kolektivisht përvojat e fituara

Tërësia e procesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin, karakterizohet nga marrëdhënie të ndërsjella. Vlerësimi i dyfishtë dhe përdorimi i të dhënave cilësore për të matur rezultatet e të mësuarit ushtron ndikim të madh në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Kjo praktikë bën që si mësuesit, edhe nxënësit të jenë të përgjegjshëm për veprimtarinë e tyre edukative dhe rezultatet e saj.

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- *dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative; (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënësve; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;
- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimi dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat* marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar aftësitë e nevojshme për veprim.

Një prej aftësive më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimi të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;

- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësimë prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

Kuptohet që të tilla kompetenca ndikojnë në zhvillimin e nxënësve; në mënyrë të veçantë ato ndikojnë në shkallën e vetëvlerësimit të tyre, në zhvillimin e një menduari të hapur, në motivimin, vlerësimin e ndryshimeve, në shkallën e të qenit të paanshëm, në tiparin krijues të kuriozitetit dhe mbi të gjitha në gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe bashkëpunuar për zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta të grupit. Duke ushtruar lirinë e tyre për të marrë pjesë në veprimtaritë e përditshme institucionale, nxënësit e tejkalojnë rolin e tyre tradicional. Ata bëhen mësues të mësuesve të tyre: shprehin pikëpamjet e tyre, i vënë në pikëpyetje veprimtaritë rutinë dhe i detyrojnë mësuesit e tyre ta riorganizojnë mësimdhënien në përshtatje me interesat e grupit. Kështu, shkollat gjithnjë e më shumë po bëhen vende ku të mësuarit lidhet me fushat e tjera të shoqërisë në tërësi, duke iu larguar gjithnjë e më shumë institucioneve të mësimdhënies së dijeve dhe shprehive formale, që kanë për rrjedhojë parcelizimin e individit dhe të çështjeve shoqërore.

Aftësitë më të rëndësishme dhe ndoshta vendimtare të nxënësve dhe të mësuesve, të nevojshme për krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi ndëraktiv të mësuarit në shkollë janë:

- *të menduarit kritik*: aftësia për të kërkuar, për të analizuar dhe për të zgjedhur informacione, duke shfrytëzuar njohuritë ndërlëndore, aftësitë e shumëfishta dhe qëndrimin kritik; aftësia për të marrë vendime mbi bazën e të dhënave dhe për të ndryshuar qëndrimet si rrjedhojë e argumenteve të vlefshme;
- *të menduarit krijues*: aftësia për të zbuluar mënyra të reja dhe të pazakonta për të grupuar faktet në kuadrin e një procesi vendimmarrjeje, që shmang në maksimum përgjithësimet e tepruara, paragjykimet dhe stereotipat;
- *të menduarit e prirur drejt sjelljeve shoqërore dhe shoqërisë*: aftësia për të analizuar faktet dhe problemet dhe për të bërë zgjedhje në interes të nevojave të të tjerëve dhe të shoqërisë në tërësi, duke luftuar egocentrizmin dhe etnocentrizmin; aftësia për të komunikuar me të tjerët dhe për të mësuar nga përvojat e ndryshme;
- *të menduarit e drejtuar nga e ardhmja*: aftësia për të identifikuar dhe kuptuar problemet dhe për të vlerësuar vendimet në dritën e përvojave, me qëllim që e ardhmja e synuar të jetë më e drejtë.

SYNIMET E PROGRAMIT TË LËNDË SË EDUKATËS QYTETARE PËR KLASËN E NËNTË

Edukata qytetare e klasës së nëntë bazohet në standardet e edukimit qytetar, kryesisht në fushën **Idealet dhe praktikat e shoqërisë**. Megjithatë, në të ndërthuren në shkallë e forma të caktuara pothuajse të gjitha fushat e standardeve të përbajtjes.

Edukata qytetare e klasës së nëntë ka për qëllim:

- T’u japë nxënësve njohuritë dhe t’u zhvillojë aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe në mënyrat e zbatimit të tyre.

- Të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- Të zhvillojë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Edukata qytetare do t'i aftësojë nxënësit mundësinë për të përcaktuar kritere dhe për të gjykuar në mënyrë kritike se deri në çfarë mase qeveria e tyre vepron ose jo si një demokraci e vërtetë.

Për nga tematika dhe mënyra e konceptimit, programi ofron mundësi që njohja e bazave të demokracisë, e vlerave dhe shprehive të pjesëmarrjes qytetare, të realizohet në lidhje të ngushtë me përvojën jetësore të nxënësve dhe të komunitetit ku jetojnë.

Në mënyrë të veçantë ky programi synon:

- t'u japë nxënësve njohuri për konceptet dhe parimet bazë të demokracisë;
- t'u japë nxënësve njohuri për tiparet e qeverisjes demokratike
- të aftësojë nxënësit të shpjegojnë organizimin dhe funksionimin e shtetit si dhe lidhjet dhe pavarësinë ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.
- të aftësojë nxënësit të analizojnë rolin e partive politike në zhvillimet aktuale shoqërore;
- të aftësojë nxënësit të vlerësojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe plotësimin e detyrave qytetare si kusht për zhvillimin e çdo komuniteti dhe forcimin e demokracisë.
- të aftësojë nxënësit të identifikojnë dhe të denoncojnë raste të shkeljes së demokracisë në realitetin ku jetojnë
- të aftësojë nxënësit të vlerësojnë rolin e shoqërisë civile dhe të pjesëmarrjes qytetare për një qeverisje të drejtë dhe demokratike;p
- të aftësojë nxënësit të zotërojnë shprehite e nevojshme qytetare për përmirësimin e jetës demokratike të shoqërisë
- të aftësojë nxënësit për të shprehur kundërshtimet në rrugë paqësore dhe efektive.
- të aftësojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë vendimarrëse
- të përdorin burime të ndryshme informacioni për të marrë vendime të drejta, për të nxjerrë konkluzione dhe për të vlerësuar veprime apo qëndrime.

Programi analitik

35 javë x 1 orë:	35 orë
Njohuri të reja:	27 orë
Kurrikula e lirë në dispozicion të mësuesit	8 orë

4. OBJEKTIVAT DHE KONCEPTET KRYESORE SIPAS FUSHAVE DHE NËNFUSHAVE TE PERMBAJTJES

Fushat e standardeve	Kreu/Objektivat	Konceptet	Numri i orëve
<p>Individët, grupet dhe institucionet</p> <p>Zhvillimi vetjak dhe identiteti,</p>	<p>KREU I. ÇËSHTË DEMOKRACIA? Në fund të këtij kreu nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të japin një përkufizim të demokracisë; • Të dallojnë konceptet e ndryshme për demokracinë; • Të krahasojnë pushtetet shtetërore që vlerësohen të ligjshme me ata që vlerësohen si jo të tillë krahasuar me tiparet që burojnë nga përcaktimi i demokracisë; • Të dallojnë tipet e ndryshme të demokracisë; • Të listojnë karakteristikat kryesore të demokracisë; • Të dallojnë argumentet që mbështesin dhe ata që i kundërvihen demokracisë; • Të mbajnë dhe shprehin qëndrimin e tyre ndaj demokracisë dhe tipareve të saj; • Të vlerësojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre duke i krahasuar me kërkesat e mendimit dhe veprimi demokratik; • Të identifikojnë, përshkruajnë dhe diskutojnë për elemente të demokracisë në bashkësinë ku jetojnë dhe në realitetin shqiptar; • Të vlerësojnë praktikatat e demokracisë në bashkësinë ku jetojnë 	<p>Demokracia</p> <p>Tipat e demokracisë</p> <p>Karakteristikat e demokracisë</p> <p>Praktikat e demokracisë</p> <p>Demokracia e drejtpërdrejtë</p> <p>Demokracia e përfaqësuar</p> <p>Kushtet e demokracisë</p> <p>Elementë të demokracisë</p>	7 orë

	<p>dhe në realitetni shqiptar;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të parashikojnë zhvillime të mundshme të fushave të ndryshme të realitetit shqiptar duke u nisur nga praktikat dhe prirjet aktuale që vihen re në të. 		
<p>Kultura,</p> <p>Koha, vazhdimësia, ndryshimi,</p> <p>Individët, grupet dhe institucionet,</p> <p>Idealet dhe praktikat e shoqërisë.</p>	<p>KREU II. FAKTORËT QË NDIHMOJNË, PENGOJNË DEMOKRACINË</p> <p>Në fund të këtij kapitulli nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojnë disa nga faktorët që mbështesin dhe pengojnë demokracinë; • Të shprehin mendimin e tyre lidhur me ekzistencën e faktorëve të tillë në bashkësinë ku jetojnë dhe realitetin shqiptar në përgjithësi; • Të japin një përcaktim lidhur me tiparet e realitetit në Shqipëri që mund të rrezikojnë demokracinë; • Të identifikojnë faktorët që ushqejnë lindjen dhe veprimin e faktorëve që rrezikojnë demokracinë në Shqipëri; • Të diskutojnë për mundësinë e zvogëlimit të veprimit të faktorëve që rrezikojnë demokracinë në Shqipëri; 	<p>Faktorë që mbështesin demokracinë</p> <p>Faktorë që pengojnë demokracinë</p> <p>Karakteristika shoqërore</p> <p>Karakteristika individuale</p>	<p>6 orë</p>
<p>Kultura,</p> <p>Njerëz, vende, mjedise,</p>	<p>KAPITULLI III - FUNKSIONIMI I DEMOKRACISË</p> <p>Në fund të këtij kapitulli nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë disa nga çështjet që duhet të zgjidhë demokracia; • Të identifikojnë çështjet që janë parësore për t'u zgjidhur nga 	<p>Funksionimi i demokracisë</p> <p>Çështje të demokracisë</p> <p>Institucion,</p>	

<p>Individët, grupet dhe institucionet,</p> <p>Idealet dhe praktikat e shoqërisë.</p>	<p>demokarcia shqiptare në rrugën e forcimit të saj të mëtjshëm;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të diskutojnë për rolin e institucioneve në realitetin shqiptar; • Të vlerësojnë veprimtarinë e institucioneve në Shqipëri duke i krahasuar me qëllimet dhe vlerat e demokracisë; • Të përshkruajnë strukturën e qeverisjes në një demokracisë; • Të diskutojnë për mënyrën e funksionimit të degëve të ndryshme të pushtetit në Shqipëri; • Të dallojnë elementë demokratikë ose jo demokratikë në funksionimin e pushtetit dhe të degëve të ndryshme të tij në Shqipëri; • Të identifikojnë faktorë të ndryshëm ekonomikë, shoqërorë, politikë, psikologjikë etj., që ndikojnë në cilën e funksionimit të pushtetit demokratik në Shqipëri; • Të shprehin mendimin e tyre për zgjidhjen e problemeve që lidhen me përmirësimin e funksionimit të demokracisë në Shqipëri; • Të përcaktojnë rolin e individëve në demokraci dhe të gjykojnë për rolin e individëve në shoqërinë shqiptare në drejtim të zhvillimit ose pengimit të proceseve demokratike; • Të listojnë kritere për të gjykuar për politikën publike në demokraci; • Të shprehin mendimin e tyre për politikën publike në bashkësinë ku jetojnë dhe atë në Shqipëri; • Të përshkruajnë rolin partive politike në demokraci dhe marrëdhëniet ndërmjet institucioneve qeveritare dhe partive politike; • Të përshkruajnë rolin e shoqërisë civile në demokraci; • Të përshkruajnë rolin e zgjedhjeve në një demokraci; • Të diskutojnë për rëndësinë e zbatimit të procedurave të drejta të 	<p>Roli i institucionit</p> <p>Kritere të demokracisë</p> <p>Strukturë e qeverisjes</p> <p>Funksion legjislativ</p> <p>Funksion ekzekutiv;</p> <p>Funksion gjyqësor</p> <p>Roli i individit</p> <p>Diskutimet</p> <p>Debati publik</p> <p>Vendimmarrjet</p> <p>Partitë politike</p> <p>Shoqëria civile</p> <p>Zgjedhjet</p> <p>Përfaqësim proporcional</p> <p>Përfaqësim individual</p>	<p>14 orë</p>
---	--	---	----------------------

	<p>votimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të diskutojnë për rëndësinë e tolerancës politike dhe të pranimit të rezultateve të zgjedhjeve (dhe të humbjes së zgjedhjeve) demokratike në një demokraci; • Të diskutojnë për karakterin demokratik ose të zgjedhjeve në Shqipëri, gjatë viteve të fundit; • Të identifikojnë elemente demokratike ose jo në realitetin zgjedhor në Shqipëri etj. 	<p>Kandidatët</p> <p>Votimi</p> <p>Procedura votimi</p>	
<p>Kultura</p> <p>Individët, grupet dhe institucionet,</p> <p>Pushteti, autoriteti, qeverisja,</p> <p>Idealet dhe praktikat e shoqërisë.</p>	<p>KREU IV. Pjesëmarrja Qytetare (8 orë)</p> <p>Objektivat e kapitullit</p> <p>Në fund të këtij kapitulli nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të diskutojnë për rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në demokraci; • Të diskutojnë për rëndësinë që ka të qenit qytetar i informuar për cilësinë e pjesëmarrjes qytetare; • Të përshkruajnë disa nga rrugët e realizimit të pjesëmarrjes qytetare në demokraci; • Të diskutojnë për mundësitë dhe rrugët e rritjes së pjesëmarrjes qytetare në realitetin ku jetojnë (lagje, shkollë, fshat, qytet etj.); 	<p>Përgjegjësi qytetare</p> <p>Pjesëmarrje qytetare</p> <p>Informim</p> <p>Gjykim kritik</p> <p>Dëgjim aktiv dhe krijues</p> <p>Interes publik</p> <p>Politikë publike</p> <p>Protestë</p> <p>Demonstratë</p> <p>Probleme vendore</p> <p>Problem kombëtar</p>	<p>8 orë</p>

5. SHPËRNDARJA E SUGJERUAR E ORËVE

Tematika	Numri i orëve
Ç'është demokracia	7 orë
Faktorët që ndihmojnë, pengojnë demokracinë	6 orë
Funksionimi i demokracisë	14 orë
Pjesëmarrja qytetare	8 orë

6. ZBATIMI I KURRIKULËS SË LIRË

Qëllimi i kurrikulës së lirë (rreth 15% e orëve totale) është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të përparësive arsimore që vendos mjedisi i veçantë në të cilin zhvillohet procesi i arsimimit

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Materiali mësimor që do të përgatitet dhe do të përzgjidhet nga mësuesi duhet t'i shërbejë realizimit të objektivave të programit dhe synimeve të përgjithshme të lëndës së edukimit qytetar e formave të tjera të edukimit që lidhen me të.

Grumbullimi i fakteve, i shifrave dhe i të dhënave të ndryshme historike, gjeografike, demografike, kulturore, industriale, bujqësore, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme prodhimi, të shoqëruara me vrojtime dhe me detyra në shërbim të realizimit të objektivave të caktuara të programit; organizimi i konkurseve dhe i lojërave të ndryshme zbavitëse që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive intelektuale dhe pjesëmarrëse dhe fuqizojnë të nxënësit dhe zhdërvjelltojnë procesin e mësimdhënies, sugjerohen për t'u zhvilluar nga mësuesi në kuadrin e orëve që ai ka në dispozicion.

Për rritjen e efektshmërisë së kurrikulës së shkollës mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera, duke programuar dhe zhvilluar veprimtari të përbashkëta që mundësojnë edhe realizimin e lidhjeve ndërlëndore.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duhet të bëhet duke analizuar me kujdes si programin ashtu edhe kërkesat që parashtrojnë veçoritë vendore.

Realizimi i sugjerimeve të mësipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por edhe aftësinë e një hartuesi të vërtetë kurrikulë, për rrjedhojë, edhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart në vetvete ky rol.

7. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Përmbajtja e lëndës së edukatës qytetare e klasës së nëntë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe fëmijëve,
- shfrytëzimin e përvojave personale të fëmijëve
- pjesëmarrjen efektive të fëmijëve në veprimtaritë mësimore
- pavarësinë e fëmijëve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake
- përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimit dhe të nxënies, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimit dhe të nxënies, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm midis fëmijëve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dala nga fëmijët, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga fëmijët në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i fëmijëve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Pretendimet e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufinjve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen “disiplinën” mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione të ndryshme, të shumta në pikëvështrime të shumëllojshme nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të fëmijëve, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst edukata shoqërore ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si raste studimi për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të pëmbushë kjo lëndë.

Në këtë kuptim “rastet e studimit” nga komuniteti shërbejnë si ura lidhëse midis formimit të fëmijëve në shkollë dhe jetën reale që përballojnë, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruarit reflektohet natyrshëm në qëndrimet që fëmija do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.

Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë në mësimit e tyre modele të ndryshme të saj, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimit ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-fëmijë, mjedis fizik, materiale

didaktike, personale të mësuesit dhe fëmijës, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë fëmijët, ku puna në grupe është e rëndësishme, por e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

8. VLERËSIMI

Parime të përgjithshme

Standardet e përmbytjes së lëndës së **edukatës qytetare** përfshijnë tri elemente të ndërlidhur me njëri tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale dhe ato të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marrë së bashku këta elementë përbëjnë bazën për zhvillimin e **edukatës qytetare** dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të pasqyrojë nevojën për të vlerësua shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementëve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetje të tilla si:

- Cila është procedura e zgjedhjeve vendore?
- Cilat janë rregullat kryesore të kalimit në një kryqëzim?

Aftësitë intelektuale dhe ato pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet si dhe të vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

Aftësitë pjesëmarrëse aftësojnë qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe atë qytetare duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, kërkuar konsensus, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një vlerësim tërësor në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimin, në atë shkallë që kjo është e mundur, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe *matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse*. Këtu duhet të sqarohet se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë **prirjet qytetare** të cilat përshkruajnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me

përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur "rregullave të lojës", si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme
- për të nxitur dhe mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet personale të nxënësve të vlerësuar.

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare duhet të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'u kërkohet të përshkruajnë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinioneve të të tjerëve. *Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.*

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kontekste të ndryshme si shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë por edhe zbatohen ato në praktikë.

Vlerësimi në lëndën e edukatës qytetare në shkollë

Vlerësimi në lëndën e edukatës shoqërore vlerësohet si një shtysë dhe motivim i pandërprerë i fëmijëve për të përballuar kërkesat e kësaj lënde. Ai nuk duhet parë thjesht në këndvështrimin e arritjeve të fëmijëve, por si një mekanizëm nxitës për pjesëmarrje me dëshirë në formimin qytetar.

Është e natyrshme që vlerësimi semestral ose përfundimtar i fëmijëve të kësaj klase do të bazohet në Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar me anë të sistemit të notave, por në këtë rast sugjerojmë që vlerësimi në veprimtaritë e edukimit qytetar të jetë një proces i gjatë, nxitës, dashamirës, të krijojë besim se fëmija është i aftë të ndryshojë dhe të bëjë diçka në këtë rrjedhë.

Si vlerësime nxitëse për fëmijët mund të shërbejnë:

- ☞ *Lavdërimi i produkteve* që bëjnë fëmijët ose të ngjarjeve që ata tregojnë për përvojat e tyre të jetuarit në shtëpi, në shoqëri, në klasë, mënyrat se si kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë qytetare në mënyrë të vazhdueshme.
- ☞ *Nxitja e fëmijëve-pjesëmarrës në punën në grupe*, duke përmendur rolet që ata kryejnë.
- ☞ *Krijimi në klasë i një këndi ekspozues për punët e fëmijëve*, i cili të ndryshojë herë pas herë për t'u dhënë mundësi të gjithë fëmijëve që të pasqyrojnë punën e tyre.
- ☞ *Përgatitja e dosjes personale për secilin fëmijë*, në të cilën të ruhen dhe të mbahen punët që ata kryejnë. Të gjitha materialet që do të mbahen u sugjerojmë mësuesve që të mos bëjnë vlerësime ose të shkruajnë mbi to shprehje vlerësuese. Renditja e produkteve që nga fillimi i vitit deri në fund u jep mundësi prindërve, mësuesve, pse jo dhe vetë fëmijës të shohë progresin që ai ka bërë nga fillimi e deri në fund të vitit mësimor.
- ☞ *Vlerësimi* që shkruhet në regjistër, sugjerohet që të jetë maksimal për të gjithë fëmijët.